

AKT THEMELIMI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“SYNERGY 2023” SH.P.K.

Sot, më date **15.03.2023**, une i nënshkruari:

- **Artan Metaj** lindur me 07/08/2001, ne Fier dhe me residence ne Tirane, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjoftimit me nr.**033647672** , madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar....; në përputhje me Ligjin Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” kam vendosur të themeloje një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar të emëruar “**SYNERGY 2023**” SH.P.K. (më poshtë referuar si “Shoqëria”), duke nënshkruar këtë Akt Themelimi. Aktiviteti i kësaj Shoqërie do të rregullohet nga Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij Akti Themelimi dhe i bashkëngjitet si Shtojca 1.

Neni 1

Emri i Shoqërisë është: “**SYNERGY 2023**” SH.P.K.

Neni 2

(1)Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Tirane , rruga “Bulevardi Bajram Curri” , pallati “1 Maj” shkalla 3 , Ap 15 , Tirane me nr pasurie 5/32+8-15/B me zone kadastrale 8260 .

(2)Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: synergy.travel.al@gmail.com
Shoqëria ka te drejte te hape dege apo filiale ne te gjithë territorin e Republikës se Shqipërisë.

Neni 3

-Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pakufizuar dhe fillon qe prej dates se regjistrimit te saj ne Regjistrin e Shoqerive Tregtare ne Qendren Kombetare te Biznesit.


Neni 4

Objekti

Shoqëria do të kryej aktivitetin e mëposhtëm :

a. Agjensi udhëtimi dhe turistike, etje .

-Megjithatë shoqëria ka te drejte qe te shtojte dhe te ndryshoje objektin e veprimtarisë se saj me vendim te asamblese se ortakeve.



Neni 5

Kapitali themeltar

(1) Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është **100 000** (njqind mije) Lekë

Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
1. Ortaku themelues **Z. Artan Metaj** : Zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme prej **100 000** (njqind mije) Leke që përbën **100 %** të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve do të jetë në para.

Neni 6:

Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Shtimi ose pakesimi i kapitalit themelor mund te behet vetem pasi Asamblea e ortakeve me shumice e ka dekretuar kete dhe per me teper te gjithë ortakët janë te detyruar qe ta repektojne dhe te kontribuojne ne para ose ne natyre ne baze te vendimit te shumices se asmblese

Neni 7:


Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit te një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e te drejtat që rrjedhin prej tyre mund te fitohen apo kalohen pëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërise
- b) shitblerjes;(me te drejten e parablerjes nga ana e ortakeve).
- c) trashëgimise;
- d) dhurimit;
- e) cdo menyre tjetër të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë ligjerisht të trasferueshme ndërmjet ortakëve,përsa nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltare janë ligjerisht të trasferueshme me rrugë trashgimnie.



Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë. Asambleja e Ortakeve është organi i vetem vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, kuorumi, marrja e vendimeve ,përjashtimi nga e drejta e votës dhe të tjera modalitete për funksionimin e organit vendimmarres percaktohen ne statutin e shoqërisë.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqërisë emerohet z.**Artan Metaj** lindur me 07/08/2001, ne Fier dhe me rezidence ne Tirane, shtetas Shqiptar i identifikuar nepermjet leternjofimit nr.**033647672**, madhor me zotesi te plote juridike per te vepruar, i zgjedhur per nje periudhe 5 vjecare me te drejte rizgjedhje.

Kompetencat dhe përgjegjësitë e Administratorit jane te percaktuara qarte ne statutin e shoqërisë.

Neni 10

Viti financiar-ekspertët

Viti financiar i shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë financiar fillon nga data e regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllet më 31 Dhjetor.

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pregatit raportin me shkrim për nxierien e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që tja paraqesë e ta dorëzojë në kohë ortakëve për ti shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.



Neni 11

Prishja-riorganizimi i shoqërisë

Modalitetet për prishjen dhe riorganizimin e shoqërisë janë të përcaktuara në statutin e shoqërisë në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Neni 12

Akti i Themelimit është hartuar në 4 kopje origjinale.

ORTAKU I VETEM I SHOQËRISE

ARTAN METAJ

A handwritten signature in blue ink, appearing to be 'A. Metaj', with a long horizontal stroke extending to the left.